



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 526/3 prot.

Tiranë, më 03 04 .2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 526/1, DATË 15.03.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIM PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESËS SË PARQAQITUR NGA SHTETASJA ZNJ. ZHULJETA VEIZAJ"**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e shtetasës znj. Zhuljeta Veizaj me nr. 1134 prot., datë 15.06.2020, ndaj veprimtarisë së magjistrates znj. Dh.B., gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin nr. 526/1, datë 15.03.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivim pas shqyrtimit fillestar të ankesës së parqajtur nga shtetasja znj. Zhuljeta Veizaj", bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, nenin 121, pika 2, shkronja a) të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
  - një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, Njësia Administrative nr. 11, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Pallati "Besa", pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
  - në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).
- Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRSGJITHSHËM

